

**MARRËVESHJE
NDËRMJET QEVERISË SË REPUBLIKËS SË AUSTRISË DHE
QEVERISË SË REPUBLIKËS SË KOSOVËS MBI TRANSPORTIN
NDËRKOBËTAR RRUGOR TË MALLRAVE DHE NË
TRANSPORTIN E KOMBINUAR**

HJRJE

Qeveria e Republikës së Austrisë dhe Qeveria e Republikës së Kosovës, të quajtura në vazhdim si palët kontraktuese,

me dëshir për të marrë parasysh në mënyrë të përshtatshme kërkesat e tregtisë së jashtme, veçanërisht

- për të organizuar transportin e mallrave ndërmjet vendeve të palëve kontraktuese në mënyrë që të garantohet sa më shumë mbrojtja e cilësisë së jetës së popullsisë dhe e mjedisit mbi territorin e Republikës së Austrisë dhe atë të Republikës së Kosovës dhe të reduktohen sa më shpejt në mënyrë sasiore dhe cilësore ngarkesat e shkaktuara nga transporti rrugor i mallrave,
- për të rregulluar në bazë të reciprocitetit transportin rrugor, hekurudhor, me anije në ujërat e brendshme dhe transportin e kombinuar të mallrave ndërmjet shteteve të palëve kontraktuese,
- për të arritur një zhvendosje sa më të madhe të transportit të mallrave nga transporti rrugor për në transportin hekurudhor ose me anije në ujërat e brendshme,
- për të siguruar që të përdoren në transportin ndërkombëtar të mallrave gjithmonë teknologjitë më të reja ekologjike sipas gjendjes së teknikës – veçanërisht për sa i përket zvogëlimit të zhurmës dhe elirimit të gazrave dhe të lëndëve të dëmshme nga ana e mjeteve të transportit të përdorura,
- për të favorizuar një zhvendosje të theksuar të transportit të mallrave të rrezikshëm nga transporti rrugor për në transportin hekurudhor ose me anije në ujërat e brendshme,
- për të përballuar nëpërmjet zbatimit të qëllimeve të kësaj marrëveshjeje gjithnjë edhe më shumë kërkesat e transportimit nëpërmjet performancave të cilësisë së lartë në transportin hekurudhor dhe me anije në ujërat e brendshme, sidomos nëpërmjet teknikave të transportit të kombinuar,

Ranë dakord si më poshtë:

I. FUSHA E APLIKIMIT

Neni 1

- (1) Kjo marrëveshje aplikohet në transportin ndërkombëtar të mallrave (bilateral dhe tranzit si dhe transportit për në dhe nga vendet e treta) ndërmjet shteteve të palëve kontraktuese.
- (2) Marrëveshja i referohet
 - transportit ndërkombëtar rrugor me mjete (neni 2, pika 2)
 - transporti ndërkombëtar i kombinuar (neni 2, pika 1)
 - transportit komercial (për palë të treta) (neni 2, pika 3) duke përfshirë transportin me mjete të zbrazëta
 - transportit në llogarinë e vet (neni 2, pika 4) duke përfshirë transportin me mjete të zbrazëta
- (3) Çështja e detyrimit të pagimit të taksave në fushën e transportit mbetet në varësi të rregullave kombëtarë dhe nuk preket nga kjo marrëveshje.

II. TERMET DHE PËRKUFIZIMET

Neni 2

Në kuptim të kësaj marrëveshjeje do të konsiderohen si

(1) Transport i kombinuar: transporti i mallrava

- a) nga pika e nisjes deri te terminali teknikisht i përshtatshëm më i afërt për mjetin rrugor, nëse kryhet në rrugën më të shkurtër të pranueshme nga pikëpamja e trafikut dhe ekonomisë së transportit dhe në përputhje me rregullat të transportit dhe pika/porti i ngarkimit (terminali) ndodhet në territorin e njëres prej palëve kontraktuese,
- b) nga pika /porti i ngarkimit deri në pikën/portin e shkarkimit me anë të hekurudhës ose anijës në një mjet të motorizuar ose në një kontajner me një gjatësi prej të paktën 6 m (transport kontajnerësh) me anën e të cilit kufiri kombëtar i njërit ose të dy shteteve të palëve kontraktuese duhet të kalojë, dhe
- c) nga një terminal teknikisht i përshtatshëm deri te marrësi i mallit me mjet rrugor, nëse kryhet me itinerarin e zakonshëm më të shkurtër, të pranueshëm nga pikëpamja e trafikut dhe ekonomisë së transportit dhe në përputhje me rregullat e transportit, dhe pika /porti i shkarkimit (terminali) është i vendosur në një nga shtetet të palëve kontraktuese (transport i prapëm).

(2) Mjet do të nënkuptojmë

Çdo mjet të motorizuar i destinuar për transportin e mallrave, duke përfshirë mjetet tërheqëse, mjetet tërheqëse me rimorkio, bashkësi automjetesh, rimorkiot dhe gjysëm-rimorkiot.

(3) Transporti për palë të tret

Transporti i mallrave me mjet që operojnë në mënyrë të pavarur, rregullisht dhe me qëllim nxjerrjen e një fitimi ose për përfitime tjera ekonomike.

(4) Transport në llogari të vet

Transport mallrash me mjete, në qoftë se plotësohen kushtet e mëposhtëne:

- a) mallrat e transportuar duhet të jenë pronë e ndërmarrjes ose të shitur, të blerë, të marrë/dhëna me qira, të marrë me leasing, të prodhuar, të fituar, të përpunuar ose të zhvilluar më tej nga ndërmarrja;

- b) transporti duhet të shërbejë për sjelljen e mallrave në ndërmarrje, heqjen e tyre nga ndërmarrja, transportimin e tyre brenda ose – me qëllim të përdorimit të vet – jashtë ndërmarrjes;
- c) mjetet e përdorur për transport duhet të ngasen nga personeli i vet ndërmarrjes;
- d) mjetet që transportojnë mallrat duhet të jenë në pronësi të ndërmarrjes ose të blerë me këste ose të marrë me qira;
- e) transportimi duhet të jetë vetëm një veprimtari ndihmëse në kuadër të veprimtarisë së përgjithshme të ndërmarrjes.

(5) Kabotazh nënkupton:

Transport mallrash ndërmjet dy pikave në territorin e njëjës prej palëve kontraktuese me mjetet e regjistruara në territorin e palës tjetër kontraktuese.

III. TRANSPORTI RRUGOR I MALLRAVE

Neni 3

Transportet për të cilat nevojitet autorizim

- (1) Pa cënuar nenin 4 nevojitet për transportin ndërkombëtar të mallrave sipas nenit 1, nëse përfshin një transport rrugor, një autorizim nga ana e autoritetit kompetent të shtetit kontraktues në të cilin zhvillohet transporti rrugor. Autorizimi duhet të lëshohet për çdo kamion.
- (2) Autorizimet lëshohen për një udhëtim ose për një numër të pacaktuar udhëtimesh në kuadër të afateve dhe të kontingjenteve të përcaktuara në nenin 8, përkatësisht:
 - a) autorizime universale (të vlefshme për per transport bilateral, tranzit ose për/nga vendet e treta, në rast të udhëtimeve për vendet e treta kalohet vandi i themelimit të ndërmarrjes);
 - b) autorizime të kufizuara (p. sh.: sipas vendit, sipas llojeve të mallrave, për mjete të caktuara ose sipas llojit të transportit).

Neni 4

Transportet për të cilat nuk nevojitet një autorizim

- (1) Një autorizim nuk nevojitet për:
 - a) transportin e rastit të mallrave për në ose nga aeroportet në rast të shërbimeve ajrore të devijuara;
 - b) për transportimin e mjeteve të dëmtuara ose që kanë nevojë për një riparim si edhe për udhëtimin e mjetit me të cilin do të kryhet riparimi;
 - c) transportin funeral;
 - d) transportimin e mallrave me automjet, pesha e përgjithshme e lejuar e ngarkesës, përfshirë edhe peshën e përgjithshme të rimorkios, nuk tejkalon 6 ton ose ngarkesa e lejuar e mallit të të cilit, duke përfshir rimorkiot nuk i tejkalon 3,5 ton;
 - e) transportimin e mallrave për përkrahjen mjekësore dhe përkrahje tjetër si edhe pajisje për ndihmë në raste urgjente (vaçanërisht në rast të fatkeqësive natyrore dhe për arsye humanitare);

- f) transportimin e pjesëve të ndërrimit për anije dhe aeroplane;
 - g) udhëtimin bosh të një automjeti të përdorur në transportin e mallrave që duhet të zëvendësojë një kamion që doli jashtë përdorimit në shtetin tjetër që nuk është shteti ku është lejuar për qarkullimin si edhe vazhdimin e transportimit nëpërmjet mjetit të rimorkimit në bazë të autorizimit të dhënë për mjetin që doli jashtë përdorimit;
 - h) transportimin e objekteve dhe të veprave të artit që nuk do të shiten për ekspozita dhe panaire ose për qëllime të tjera jo komerciale;
 - i) transportimin e pajisjeve, të pjesëve plotësuese dhe të kafshëve që nuk do të shiten për në ose nga shfaqje teatrale, muzikore, të filmave, sportive dhe të cirkut, ekspozita ose panaire si edhe për inçizime të radios, filmime ose inçizime televizive.
- (2) Përveç kësaj Komisioni i Përbashkët (neni 10) mund të vendosë që për transportin e disa ose të të gjitha mallrave nuk nevojitet autorizim në itinerare të caktuara të transportit rrugor ndërkombëtar.

- (3) Transportuesi duhet të dëshmojë se udhëtimet pa ngarkes te perjashtuara kryhen ne lidhje me nje transport ne perputhje me paragrafin 1 dhe 2. transporti pa ngarkese ne lidhje me transportet e perjashtuara ne perputhje me paragrafin 1 dhe 2 duhet te provohet me ane te nje fature ngarkese malli ose me ane te prezantimit dhe me pas kthimit te nje leje te kuotes.

Neni 5 Përmbajtja e autorizimit

- (1) Pa cënuar nenin 4 duhet të lëshohet një autorizim për çdo mjet.
- (2) Autorizimi duhet të përmbajë të dhënat e mëposhtme:
- a) emrin dhe adresën e operatorit të transportit;
 - b) targat zyrtare të mjetit;
 - c) peshën maksimale të shfrytëzueshme dhe peshën maksimale të përgjithshme të lejuar të mjetit;
 - d) llojin e transportit (transport komercial, transport në llogari të vet, udhëtim të zbrazët);
 - e) eventualisht kushte të veçanta përdorimi;

- f) kohëzgjatjen e vlefshmërisë.
- (3) Autorizimi vlen ekskluzivisht për transportuesin në emër të të cilit ai është lëshuar dhe nuk është i transferueshëm
- (4) Autoriteti kompetent i njërës prej palëve kontraktuese ia transmeton autoritetit kompetent të palës tjetër kontraktuese autorizimet që do të plotësohen nga ky i fundit me përjashtim të të dhënave sipas paragrafit 2, pikat b, c dhe d, që plotësohen nga operatori i transportit para fillimit të udhëtimit dhe do t'u dorëzohen transportuesit që vijnë në konsideratë.
- (5) Autorizimi i plotësuar komplet duhet të mbahet në mjet gjatë gjithë udhëtimit dhe duhet t'u paraqitet në çdo kohë organeve të kontrollit nëse ato e kërkojnë.
- (6) Autoritetet kompetente të palëve kontraktuese merren vesh për formën dhe gjuhët në të cilat do të lëshohet autorizimi.

Neni 6 Ndalimi i kabotazhit

- (1) Kabotazhi nuk është i lejuar.
- (2) Pa cënuar paragrafin 1 mund të merret vesh në rast të transportit të kombinuar për transportin paraprak dhe të prapëm të kryhet në bazë të reciprocitetit një numër i caktuar udhëtimesh me kabotazh.

Artikel 7 Sanksionet

- (1) Operatorët e transportit si edhe personeli i tyre që kryen transport janë të detyruar të respektojnë gjatë udhëtimit në territorin e palës tjetër kontraktuese të gjitha dispozitat ligjore që janë në fuqi në territorin e palës tjetër kontraktuese.
- (2) Në rast të shkeljeve të rënda ose të përsëritura të rregullave sipas paragrafit 1 ose të dispozitave të kësaj marrëveshjeje nga ana e një operatorit të transportit dhe e personelit të tij që kryen udhëtimet autoritetet kompetente të shtetit në të cilin ndërmarrja ka vendndodhjen mund të marrin në bazë të kërkesës së autoritetit kompetent të shtetit në të cilin u krye shkelja masat e mëposhtme:
- a) t'i kërkojnë operatorit të transportit të respektojë rregullat në fuqi (paralajmërim);

- b) të ndërpresin lëshimin e autorizimeve për transportuesin ose t'i marrin autorizimet e dhëna;
- c) ta përjashtojnë transportuesin përkohësisht nga transporti rrugor ndërkombëtar i mallrave në bazë të kësaj marrëveshjeje.

(3) Autoritetet kompetente të palëve kontraktuese merren vesh për mosnjohjen e autorizimeve që janë lëshuar transportuesve që kanë shkelur disa herë dispozitat e kësaj marrëveshjeje.

(4) Autoritetet kompetente të palëve kontraktuese do të informojnë njëra-tjetrën për çdo shkelje të kësaj marrëveshjeje dhe për çdo masë në kuptim të paragrafit 2.

Neni 8 Kontingjentet

Numri i autorizimeve (kontingjentet), vlefshmëria, koha dhe intervali i dorëzimit do të caktohen nga Komisioni i Përbashkët (neni 10).

Neni 9 Mjetet ekologjike

Në përputhje me synimet të mbrojtjes së popullsisë dhe të mjedisit mendohet të përdoren sa më shpejt mjete ekologjike sipas gjendjes së teknikës. Komisioni i Përbashkët (neni 10) do të propozojë masa nxitëse për përdorimin e mjeteve të tillë dhe do të lidhë në mënyrë të shkallëzuar kontingjentet për të cilat do të merret vesh me përdorimin e mjeteve të tillë.

IV. KOMISIONI I PËRBASHKËT

Neni 10

- (1) Autoritetet kompetente të palëve kontraktuese do të ngrisin një Komision të Përbashkët për zbatimin e dispozitave të kësaj marrëveshjeje.
- (2) Komisioni i Përbashkët do të mbledhet në bazë të kërkesës së autoritetit kompetent të njëjës prej palëve kontraktuese.
- (3) Nëse Komisioni i Përbashkët do të trajtojë çështje që kanë të bëjnë me fusha të tjera të administratës, mund të ftojë përfaqësues të autoriteteve përkatëse kompetente.

V. DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE

Neni 11 **Hyrja në fuqi**

Kjo marrëveshje hyn në fuqi në ditën e parë të muajt të dytë pasi që palët kontraktuese do të kenë informuar njëra-tjetrën për mbarimin e procedurave të parashikuara ligjore nga shteti përkatës.

Neni 12 **Kohëzgjatja e marrëveshjes**

Kjo marrëveshje lidhet për një kohëzgjatje prej katër vjetësh. Vlefshmëria e saj do të zgjatet për edhe një vit, nëse nuk është denoncuar me shkrim nga njëra prej palëve kontraktuese jo më vonë se tre muaj para mbarimit të këtij afati.

E bërë në Vjenë më 21. Qershor. 2013 në dy ekzemplarë origjinalë, në gjuhën gjermane dhe shqipe, të dy tekstet të jenë njësoj dhe autentike.

Për Qeverinë e
Republikës së Austrisë

Për Qeverinë e
Republikës së Kosovës

Mag. Ursula Zechner

Dr. Sabri Kiqmari